



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla ZRRE/Nr. 06/2017

RREGULLA PËR MASAT ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Prishtinë, 31 mars 2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7, Nenin 26, Nenin 57 dhe Nenin 58 paragrafin 2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), në seancën e mbajtur me datë 31 mars 2017 miratoi:

RREGULLËN PËR MASAT ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

Qëllimi i kësaj Rregulle është mbikëqyrja e aktiviteteve në sektorin e energjisë si dhe ndërmarrja e masave administrative dhe gjobave, në rast të shkeljes së tyre.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **Informatë konfidenciale**- të dhëna, dokumente apo informacione të tjera, komerciale apo teknike, që kanë të bëjnë me dizajnin, rehabilitimin, sigurinë, veprimin, mirëmbajtjen dhe financimin e veprimeve energjetike apo aktivitete që nuk janë më në domenin publik dhe që shpallja e tyre mund t'i vë në rrezik interesat komerciale të aplikuesve apo te të licencuarve;
 - 1.2 **Person**- person fizik ose juridik.
 - 1.3 **Zyra e Rregullatorit për Energji** - (në tekstin e mëtejshëm: Rregullatori) – është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
2. Shprehjet e përdorura në këtë Rregull, kanë kuptimin e shprehjeve të përdorura në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Gazin Natyror, Ligjin për Ngrohjen Qendrore, Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

KREU II

MBIKËQYRJA

Neni 3

Mbikëqyrja nga Rregullatori

1. Bazuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Rregullatori mbikëqyrë funksionimin e aktiviteteve në sektorin e energjisë.
2. Zyra e Rregullatorit për Energji ushtron mbikëqyrje për:
 - 2.1 pajtueshmërinë me kushtet e licencës;
 - 2.2 zbatimin e tarifave të rregulluara dhe metodologjive tarifore;
 - 2.3 zbatimin e rregullave, akteve të veçanta përfshirë edhe vendimet e tjera të nxjerra nga Rregullatori, dhe
 - 2.4 zbatimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Ligjit për Energjinë Elektrike, Ligjit për Energjinë Termike dhe Ligjit për Gazin Natyror.
3. Gjatë ushtrimit të detyrave mbikëqyrëse, Rregullatori:
 - 3.1 miraton vendime;
 - 3.2 kryen inspektime përmes personave të autorizuar nga ajo;
 - 3.3 njofton autoritetet publike ose organet e pavarura mbi masat që duhet të ndërmerren brenda kompetencave të tyre;
 - 3.4 imponon masa të detyrueshme administrative dhe gjoba, të parapara me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe ligjet tjera që rregullojnë sektorin e energjisë; dhe
 - 3.5 suspendon, modifikon apo tërheq licencën.
4. Personat përgjegjës të Rregullatorit do të mbikëqyrin aktivitetet në pajtim me paragrafin 1 të këtij Neni në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Rregullat e nxjerra nga Rregullatori dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
5. Personat përgjegjës si në paragrafin 4 të këtij Neni do të përgatisin raport lidhur me të gjeturat nga mbikëqyrja e bërë, i cili raport do t'i paraqitet Bordit të Rregullatorit.
6. Personat përgjegjës gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, sipas nevojës, do të bashkëpunojnë me të gjitha autoritetet relevante në Kosovë.
7. Bazuar në Nenin 54 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, gjatë përmbushjes së mbikëqyrjes, Rregullatori mund të kryejë inspektime nëpërmjet personave të autorizuar nga Bordi i Rregullatorit të cilët do të kryejnë inspektime të pajisjeve në objekte të licencuarit dhe akterëve tjerë të sektorit të energjisë (vizita periodike me paralajmërim apo pa paralajmërim);

njoftojë autoritetet publike apo organet e pavarura mbi masat që duhet të ndërmerren brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre.

Neni 4

Detyrimet e të Licencuarit

1. I licencuari do të përgjigjet Rregullatorit gjatë procesit të mbikëqyrjes dhe do të sigurojë çdo të dhënë dhe informacion të kërkuar brenda periudhës së përcaktuar në licencë, Doracakun e Raportimit, në ndonjë Urdhëresë, Udhëzim apo dokument tjetër për të licencuarin, të lëshuar nga Rregullatori.
2. I licencuari duhet të informojë Rregullatorin brenda afatit të kërkuar, për çdo pengesë ligjore, teknike ose administrative, përpara se të ndodhë mbikëqyrja ose inspektimi që do të kryhet nga personat përgjegjës respektivisht të autorizuar.
3. I licencuari duhet të respektojë çdo afat dhe udhëzim të dhënë nga Rregullatori .

KREU III

MASAT ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Neni 5

Parimet për vendosjen e masave administrative dhe gjobave

1. Nëse i Licencuari vepron në kundërshtim me dispozitat e Nenit 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Rregullatori do të vlerësojë dhe do të vendosë për shqiptimin e masave dhe gjobave, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle.
2. Forma dhe lartësia e gjobës do të bazohet në numrin , llojin dhe peshën e shkeljes.

Neni 6

Faktorët lehtësues

1. Faktorët që mund të konsiderohen si lehtësues gjatë shqiptimit të masave administrative apo gjobave janë:
 - 1.1. i licencuari është përpjekur të parandalojë ose të pakësojë dëmin e shkaktuar nga shkelja;
 - 1.2. shkalla e dëmit që i është bërë shoqërisë;
 - 1.3. sjellja paraprake e personit;
 - 1.4. gjendja financiare e personit etj.

Neni 7

Raporti fillestar i mbikëqyrjes

1. Personat përgjegjës apo personat e autorizuar nga Rregullatori, pas përfundimit të mbikëqyrjes përgatisin Raportin fillestar me të gjeturat mbi shkeljet eventuale të konstatuara, i cili do të dorëzohet Bordit të ZRRE-së për shqyrtim.
2. Bordi pas shqyrtimi dhe vlerësimit të Raportit fillestar të mbikëqyrjes, do t'ia dërgojë atë të licencuarit në mënyrë që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike të përgjigjet me shkrim lidhur me të gjeturat në Raport.

Neni 8

Masat Administrative

1. Pas pranimit dhe vlerësimit të përgjigjeve dhe komenteve eventuale nga i Licencuari, Bordi i ZRRE mund të vendosë masat administrative, si në vijim:
 - 1.1. të obligojë që i Licencuari të ndërpresë kryerjen e aktiviteteve që shkaktojnë shkeljen e kushteve dhe obligimeve të licencës;
 - 1.2. shpallë të pavlefshëm çdo akt ose vendim që përbënë shkeljen, ta anulojë dhe ta shfuqizojë atë.
 - 1.3. të obligojë që i Licencuari të kryejë të gjithë veprimet e arsyeshme që konsiderohen si të nevojshme për eliminuar efekteve negative, dhe se kjo shkelje nuk do të përsëritet më.
 - 1.4. të përcaktojë masa të përkohshme në lidhje me shkeljet e të licencuarit.

Neni 9

Gjobat

1. Pavarësisht masave administrative të përcaktuara me nenin 8 të kësaj Rregulle, në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE mund të vendosë edhe gjoba për shkeljet si në vijim:
 - 1.1. punëson persona që nuk kanë kualifikimet e kërkuara sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.2. nuk arrin të përmbushë detyrat e tij/saj sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.3. nuk jep informata të kërkuara sipas nenit 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë ;
 - 1.4. zbulon informata konfidenciale në mënyrë të papranueshme;
 - 1.5. nuk jep ndihmën e kërkuar sipas nenit 13 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;

- 1.6. nuk vepron në pajtim me masat e imponuara sipas nenit 16 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë për të parandaluar keqpërdorimin e pozitën dominuese;
 - 1.7. merret me aktivitete energjetike për të cilat nevojitet licenca, pa pasur licencë;
 - 1.8. nuk arrin të përmbushë kushtet apo afatet e licencës;
 - 1.9. ndërton stabilimente sipas Kapitulli VIII të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë pa marrë autorizimin;
 - 1.10. vendos tarifa që janë subjekt rregullimi, pa miratimin e Rregullatorit;
 - 1.11. mban llogaritë në mënyrë që nuk është në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës;
 - 1.12. refuzimi i lidhjes së kontratave për furnizimin e energjisë, për të siguruar qasje në sisteme pa arsytim të qëndrueshëm;
 - 1.13. lidhet në rrjet pa respektuar kushtet përkatëse;
 - 1.14. vepron në kundërshtim me Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Energjinë, Rregullat e përcaktuara në pajtim me këto ligje, apo standardet ose kodet përkatëse teknike.
2. Për Shkeljet e përcaktuara nga paragrafi 1 të këtij Neni, të licencuarit do t'i shqiptohet gjoba nga pesëmijë (5,000.00 €) euro e deri në shumën 10% të të ardhurave që ndërmarrja ka akumuluar gjatë vitit paraprak fiskal.
 3. Në rastet kur dënimi i cekur në paragrafin 1 të këtij neni i shqiptohet një individ, nuk mund të tejkalohet 300% e rrogës mujore të individit.
 4. Niveli i gjobës që do të shqiptohet sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij Neni do të varet nga faktorët si në vijim:
 - 4.1 vlera materiale e dëmit të shkaktuar;
 - 4.2 numri i konsumatorëve të prekur;
 - 4.3 përfitimet financiare nga ngarkimet e konsumatorëve dhe veprimet e paligjshme të ndërmarrja; dhe
 - 4.4 ndikimi i shkeljes në funksionimin e tregut të energjisë.
 5. Në rast të shkeljes së përsëritur, dënimi i shqiptuar mund të jetë tri (3) herë më i madh se shuma e cekur në paragrafin 2 dhe 3 të këtij Neni.

6. Gjatë shqiptimit të një dënimi sipas këtij neni, Rregullatori duhet të njoftojë personat për shkeljet e bëra dhe t'iu japë mundësi dhe kohë që të përgjigjen me shkrim, brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga njoftimi.
7. Në rast mos pagesës të dënimit të shqiptuar nga Rregullatori, Rregullatori me padi inicion procedurën gjyqësore në gjykatën kompetente.
8. Vendimi i Rregullatorit për shqiptimin e ndonjë gjobe sipas kësaj Rregulle, në asnjë mënyrë nuk kufizon të drejtën e saj për të pezulluar/anuluar licencën.
9. Vendimi për shqiptimin e gjobës apo masës administrative nxjerrë nga Rregullatori mund të kontestohet në Gjykatën kompetente.
10. Ankesa kundër vendimit të Rregullatorit për gjobë apo masë administrative nuk do ta shtyjë ekzekutimin e vendimit.
11. Gjoba e shqiptuar ndaj të licencuarit nuk përjashton përgjegjësinë e tij civile dhe penale sipas legjislacionit në fuqi.
12. Nëse gjoba e shqiptuar nga Rregullatori nuk paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor, Rregullatori do të filloj procedurën gjyqësore për pagesën e gjobës si borxh civil.
13. Të gjitha gjobat e mbledhura sipas këtij neni do të paguhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

KREU IV

NDËRPRERJA APO PEZULLIMI I LICENCËS

Neni 10

Ndërprerja apo pezullimi i Licencës

1. Rregullatori do të marrë të gjithë hapat e nevojshëm, përfshirë vendosjen e gjobave, nëse këto të fundit ose masat tjera, mund të eliminojnë arsyet për përfundimin ose tërheqjen e licencës. Ndërprerja apo pezullimi duhet përdorur si hapi i fundit, nëse të gjitha masat e tjera të përcaktuara në këtë Rregull nuk kanë arritur të japin efektin e dëshiruar.
2. Rregullatori mund të ndërpresë apo pezullojë licencën në përputhje me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
3. Ndërprerja apo pezullimi i licencës do të hyjë në fuqi pas nxjerrjes së Vendimit me shkrim nga Bordi i Rregullatorit.
4. Në rast se Rregullatori ka nxjerrë një Vendim që i referohet paragrafit 5 të këtij Neni, atëherë ai do të emërojë një të licencuar tjetër për të mbrojtur sigurinë e furnizimit dhe për të vënë në funksion asetet që i përkasin të licencuarit të cilit i është tërhequr licenca.
5. Vendimi për ndërprerje apo pezullim të licencës nxjerrë nga Rregullatori mund të kontestohet në Gjykatën kompetente.

KREU IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 11

Ndryshimi

1. Rregullatori mban të drejtën që të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedurat për ndryshim dhe modifikim të kësaj Rregulle, do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 16

Interpretimi

Në rast të paqartësive për dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 18

Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat, nxjerr në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185) dhe të miratuar nga Bordi i Rregullatorit me datë 17.06.2011.

Neni 19


Hyrja në Fuqi

Rregulla hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:



Krenar Bujupi, U.D kryesues



Arsim Janova, anëtar



Besim Sejfiqaj, anëtar